

Qeveria të hartojë plan emergjent për përballimin e pasojave ekonomike të COVID-19

Prishtinë, 23 mars 2020 - Republika e Kosovës është duke kaluar nëpër një gjendje të rëndë si rezultat i pandemisë COVID-19. Përveç pasojave shëndetësore, kjo gjendje është duke shkaktuar edhe pasoja të rënda ekonomike.

Ndarja e ndihmave sociale 10 ditë para kohe dhe atë për dy muajt e ardhshëm, duke e falur pagesën e dytë, është një hap i Qeverisë që duhet vlerësuar, sikurse edhe paralajmërimi i ekzekutimit të hershëm të pagave për të punësuarit në sektorin publik. Por, Qeveria duhet të jetë shumë më e pranishme në trajtimin e pasojave ekonomike duke marrë masa shtesë e me shtrirje më të gjerë, me theks të veçantë në minimizimin e pasojave për të punësuarit në sektorin privat dhe rastet sociale. Në anën tjetër, jemi të vetëdijshëm për kapacitetet e kufizuara të Qeverisë së Kosovës për t'u përballur me këtë armik të padukshëm.

Për këtë arsye, organizatat e shoqërisë civile të renditura më poshtë, kërkojnë nga Qeveria e Kosovës që urgjentisht të **hartojë dhe zbatojë një plan emergjent ekonomik**, me qëllim të vënies në dispozicion të të gjitha burimeve shtetërore dhe mobilizimit të burimeve tjera për përballimin e kësaj situatë të rëndë. Ndër të tjera, i propozojmë Qeverisë së Kosovës që:

1. Në pajtim me ligjet e aplikueshme të shfrytëzojë mundësitë e hyrjes në kredi, dhe të bëjë rishikimet e nevojshme buxhetore dhe të prioritetëve programore, **për të krijuar fonde që përdoren për masa sa më universale mbështetëse ekonomike**, me prioritet sektorin privat;
2. **Të themelojë një Fond të solidaritetit** që menaxhohet dhe administrohet nga Qeveria e Kosovës, ku të gjithë të interesuarit brenda dhe jashtë Kosovës të mund të ofrojnë ndihmë financiare sipas vullnetit të mirë. Të gjitha mjetet e gjeneruara të shfrytëzohen për menaxhimin e situatës rreth COVID-19, duke u dhënë përparësi përballimit të nevojave emergjente të rasteve më të rrezikuara. Menaxhimi dhe administrimi i Fondit të bëhet në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, me raporte të detajuara gjatë dhe pas tejkalimit të kësaj situatë.

Gjithashtu, i rikujtojmë Qeverisë së Kosovës kërkesat tona që së bashku me Bankën Qendrore të Kosovës të hyjnë në dialog urgjent me sektorin bankar në Kosovë për të **pezulluar pagesat e kredive për të gjithë kredi-marrësit në një afat të paktën 3 muajor**. Kjo, pa aplikuar kamatë-vonesat për këtë periudhë pezullimi.

Në fund, kërkojmë nga ministrat përkatës të ekonomisë dhe financave dhe zyrtarët tjerë përgjegjës që të ofrojnë informata të vazhdueshme dhe të detajuara, për t'u ofruar qytetarëve sigurinë e nevojshme që përveç aspektit shëndetësor, shteti është plotësisht i përkushtuar të udhëheqë edhe përballimin e pasojave ekonomike të shkaktuara nga shpërthimi i COVID-19.

Organizatat e shoqërisë civile mbesin të gatshme që të mbështesin Qeverinë e Kosovës në dizajnimin ose zbatimin e çfarëdo mase në të cilat kapacitetet tona vlerësohen të dobishme.

Organizatat përkrahëse:

- Demokraci për Zhvillim (D4D)
- Demokraci Plus (D+)
- Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)
- Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)
- GWY/YMCA
- Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)
- Instituti GAP
- Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)
- Instituti i Kosovës për Politikat Evropiane (EPIK)
- Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)
- Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)
- Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMLDNj)
- Lëvizja FOL
- Let's Do It Kosova
- Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!
- Organizata “INTEGRA”
- Organizata “POLIS”
- Organizata “VKBIK”
- Organizata “PLEJADA”
- Organizata “RROGRAEK”
- Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K)
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)
- Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore
- Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK)
- Shoqata e Intelektualëve të Pavarur, Deçan
- Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK)